

V E N D I M
Nr.31, datë 23.3.1999

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““

Me sekretare Drita Filto, më datë 20.10.1998, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën nr.51/2 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: ISA MYSHKETA, i përfaqësuar nga avokat Rifat Aliu.

SUBJEKT I INTERESUAR: KRISANTHI QIRKO, në mungesë.

O B J E K T I:

Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.3186, datë 24.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Durrës; nr.1631, datë 22.3.1996 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1422, datë 8.10.1996 të Gjykatës së Kasacionit.

Kërkuesi parashtron si shkak për antikushtetutshmërinë e vendimeve, mosrespektimin nga gjykatat të kërkesave të nenit 8/2 të Ligjit Kushtetues nr.7561, datë 29.4.1992, duke tejkaluar kompetencat e tyre. Ai shton se nga gjykatat nuk është marrë parasysh instituti i parashkrimit, fakt ky që i bën gjykimet të padrejta.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi shpjegimet e përfaqësuesit të palës dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Sipas nenit 131 gërma “f” të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese, vendos përfundimisht lidhur me ankesat e individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Mbi këtë bazë, në objektin e shqyrtimit në Gjykatën Kushtetuese hyjnë dhe ato kërkesa që kanë të bëjnë me çështje gjyqësore të paraqitura nga individët për shkelje të të drejtave të tyre kushtetuese, pasi vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë dhe nuk ekzistojnë më mjete juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Gjatë kohës që kjo çështje shqyrtohej në Gjykatën Kushtetuese, me ligj u krijuan mjete të tjera për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Kështu, sipas nenit 5 të Ligjit nr.8432, datë 14.12.1998 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”, kundër vendimeve të formës së prerë, vendimeve të mospranimit të rekursit si dhe vendimeve të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë, palët kanë të drejtë që për shkaqet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”

dhe “c” të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, të bëjnë rekurs në Kolegjet e Bashkuara brenda 3 vjetëve nga marrja formë të prerë e vendimit.

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji më datë 26.1.1999, shqyrtimi i kësaj çështje nuk është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, sepse nuk është përdorur akoma mjeti i fundit ligjor nga pala e interesuar, rekursi në Gjykatën e Lartë.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese, e cila garanton respektimin e Kushtetutës, detyrohet të zbatojë nenin 131 gërma “f” të saj, duke i dhënë mundësinë kërkuesit që të konsumojë edhe këtë mjet ligjor për mbrojtjen e të drejtave të tij.

PËR KËTO ARSYE ;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f dhe 133 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, njëzëri,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës për mungesë juridiksioni.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 23.3.1999

Nr. 51/2 i regjistrimit themeltar

Nr. 31 i vendimit